

VENDIM
Nr. 505, datë 10.6.2015

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E KOMISIONEVE
EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39/2, pika 4, e 39/3, pika 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e komisioneve eprore mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (më poshtë Komisioni Epror), si struktura kolegjiale mjekësore dhe ligjore, të cilat funksionojnë për shqyrtimin e ankesave të personave të interesuar lidhur me vendimet e marra nga komisionet e nivelit të parë për vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe të aftësive për punë, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Për shqyrtimin në afat të ankesave, të ngrihen 10 komisione eprore, nga të cilat 6 komisione ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe 4 komisione ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Shërbimit Social Shtetëror, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Anëtar i Komisionit Epror, pas zgjedhjes në detyrë dhe përpara fillimit të ushtrimit të detyrës, betohet në një ceremoni publike, të organizuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë, sipas tekstit të dhënë në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Anëtarët e komisioneve eprore, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre në komision, nuk mund të jenë pjesë e vendimmarrjes së drejtimit të të sëmurëve, invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara në KMCAP-të e të dyja niveleve.

4. Kryetari i KMCAP-së epror ka për detyrë të organizojë dhe të drejtojë mbledhjen e këtij komisioni, krahas detyrave dhe përgjegjësisë të tjera të ngjashme me ato të anëtarëve të KMCAP-së Epror, të cilët:

a) nuk angazhohen në detyrat e përditshme të ushtrimit të profesionit të tyre, si dhe punojnë me kohë të plotë gjatë ditëve që janë të mbledhur në Komision, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror;

b) mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e konfidencialitetit mbi të dhënat personale të ankimuesve, për të cilat ata kanë marrë dënim gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, mbi procesin e vlerësimit paraprak dhe të marrjes së vendimit, si dhe për votën pro ose kundër gjatë marrjes së vendimit për përcaktimin e aftësisë për punë/aftësisë së kufizuar;

c) shpërblehen sipas parashikimeve të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore".

5. Anëtarët e komisioneve eprore ushtrojnë funksionet e tyre për:

a) shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të të sëmurëve, invalidëve apo personave me aftësi të kufizuara, që ankimojnë vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë;

b) studimin dhe vlerësimin para dhe gjatë zhvillimit të seancës të relacionit të hartuar nga relatori, mjek i ekspertizës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror, duke shqyrtuar dokumentacionin mjekësor dhe ligjor të dosjes, duke kryer vizita të drejtpërdrejta të ankimuesit dhe, në raste të caktuara, edhe duke kërkuar ekzaminime të specializuara, përveç atyre të përmendura në dosje;

c) caktimin e aftësisë për punë dhe të shkallës së invaliditetit, në bazë të gjendjes shëndetësore të ankuesit dhe të kriterëve mjekësorë, të përcaktuara e të miratuara për nivelin e aftësisë për punë apo të aftësive shëndetësore të kufizuara, dhe marrjen e vendimit;

ç) kryerjen e studimeve mbi gjendjen dhe ecurinë e invaliditetit/aftësisë së kufizuar, drejtimet dhe zgjidhjet për përmirësimin e treguesve.

6. Procedura e ankimit kryhet, si më poshtë vijon:

a) Ankimi në Komisionin Epror bëhet me shkrim, sipas formularit tip, të dhënë në aneksin 3 bashkëlidhur këtij vendimi dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore /agjencie rajonale të sigurimeve shoqërore /drejtorive rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

b) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore

/Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore/Shërbimin Social Shtetëror dosjen e të sëmurit, të invalidit ose personit me aftësi të kufizuar, së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-ja e nivelit të parë;

c) Administrata e Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror njofton anëtarët e KMCAP-së Epror dhe ankimuesit, 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të seancës së Komisionit Epror.

7. Mjeku i ekspertizës mjekësore/punonjësi social pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore / Shërbimit Social Shtetëror, në rolin e relatorit, studion dokumentacionin e dosjes, procedurat e zbatuara në KMCAP-në e nivelit të parë, dokumentacionin e vlerësuar nga ky Komision, pretendimet e parashtruara nga ankimuesi dhe përgatit një relacion, ku, ndër të tjera, shprehet edhe për referencën e gjendjes shëndetësore të ankimuesit, sipas kriterëve mjekësore orientuese për përcaktimin e aftësisë për punë/aftësisë së kufizuar.

8. Seanca mujore e mbledhjes së Komisionit zhvillohet, si më poshtë vijon:

a) Vetëm në rastet kur janë mbledhur jo më pak se 20 dosje ankimuesish. Në çdo rast, komisionimi i ankimuesve duhet të bëhet brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së doku-menteve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore / Shërbimin Social Shtetëror;

b) Zhvillohet edhe me 4 anëtarë, por, në asnjë rast, nuk mund të zhvillohet në mungesë të kryetarit. Kur ka barazi në votim, në përfundim vendos vota e kryetarit;

c) Në rast se provohet mungesa me arsye e më shumë se një anëtar, atëherë njoftohet për pjesëmarrje në mbledhje zëvendësuesi respektiv, i përcaktuar për çdo Komision Epror. Kriteret dhe procedura e miratimit të anëtarëve zëvendësues është e njëjtë me kriteret dhe procedurën e anëtarëve të miratuar;

ç) Zhvillohet në ditën e caktuar nga Komisioni Epror i cili tërhiqet për të marrë vendim, pa praninë e personit.

9. Vendimet e Komisionit Epror merren me shumicë të thjeshtë votash. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të argumentojnë votën e tyre pro ose kundër.

10. Në vendimin e Komisionit Epror, që plotësohet sipas formularit të caktuar, të dhënë në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi, përcaktohen:

a) diagnoza me kodin përkatës të sëmundjes;

b) shkalla e humbjes së aftësisë për punë / aftësisë së kufizuar;

c) shkaku i invaliditetit, si: sëmundje e përgjithshme, aksident në punë ose sëmundje profesionale;

ç) koha e fillimit të invaliditetit/aftësisë së kufizuar;

d) periudha e përfitimit dhe afati i rikontrollit;

dh) kushtet dhe karakteri i punës që duhet të kryejë invalidi/personi me aftësi të kufizuara;

e) masat që duhen marrë për riaftësimin e plotë fizik, si dhe drejtimit për riaftësimin profesional të invalidit/personit me aftësi të kufizuara.

11. Vendimi i Komisionit Epror arkivohet në dosjen përkatëse dhe i njoftohet me shkrim edhe ankimuesit, brenda një afati 8-ditor.

12. Nëse ankimuesit nuk paraqiten për komisionim 2 herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, Komisioni Epror merr vendim “pa invaliditet/pa aftësi të kufizuar”, dhe dosja i kthehet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore/Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në këtë rast dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten për komisionim për herë të parë.

13. Komisioni Epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë, në rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore apo aftësi të kufizuar.

14. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe për Shërbimin Social Shtetëror.

15. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 1

Emërtesat dhe specialitetet e KMCAP-eve Eprore

Nr.	KMCAP	Funksioni në KMCAP	Specialiteti
1	<i>Sëmundjet e Brendshme (Pneumo/Fiziatri + Patologji) (ISSH)</i>	Kryetar	Pneumolog/Alergolog
2		Anëtar	Nefrolog
3		Anëtar	Reumatolog
4		Anëtar	Gi/Hepatolog
5		Anëtar	Jurist
6	<i>Kardiologji (ISSH)</i>	Kryetar	Kardiolog
7		Anëtar	Kardiolog
8		Anëtar	Kardiokirurg
9		Anëtar	Hipertonist
10		Anëtar	Jurist
11	<i>Neurologji (ISSH)</i>	Kryetar	Neurolog
12		Anëtar	Neurolog
13		Anëtar	Neurolog
14		Anëtar	Neurokirurg
15		Anëtar	Jurist
16	<i>Kirurgji (ISSH)</i>	Kryetar	Onkolog
17		Anëtar	Onkolog
18		Anëtar	Onkolog
19		Anëtar	Angiokirurg
20		Anëtar	Jurist
21	<i>Ortopedi (ISSH)</i>	Kryetar	Ortoped
22		Anëtar	Ortoped
23		Anëtar	Ortoped
24		Anëtar	Ortoped
25		Anëtar	Jurist
26	<i>Psikiatri Okulistikë (ISSH)</i>	Kryetar	Psikiatër
27		Anëtar	Psikiatër
28		Anëtar	Okulist
29		Anëtar	Okulist
30		Anëtar	Jurist
31	<i>Sëmundjet e Shëndetit Mendor (SHSSH)</i>	Kryetar	Psikiatër
32		Anëtar	Psikiatër
33		Anëtar	Psikiatër
34		Anëtar	Psikolog klinik
35		Anëtar	Jurist
36	<i>Sëmundjet e përgjithshme para moshës 21 vjeç (SHSSH)</i>	Kryetar	Neuropediatër - Elektrofiziolog
37		Anëtar	Nefrolog ose Internist
38		Anëtar	Endokrinolog
39		Anëtar	Kardiopediatër
40		Anëtar	Jurist
41	<i>Verbëri (SHSSH)</i>	Kryetar	Okulist
42		Anëtar	Okulist
43		Anëtar	Okulist
44		Anëtar	Okulist për fëmijë
45		Anëtar	Jurist
46	<i>Para dhe tetraplegjia (SHSSH)</i>	Kryetar	Neurokirurg
47		Anëtar	Neurokirurg
48		Anëtar	Neurolog - elektrofiziolog
49		Anëtar	Imazherist
50		Anëtar	Jurist

Aneksi 2

TEKSTI I BETIMIT

“Me të hyrë në rradhët e anëtarëve të Komisionit Epror, betohem solemnisht se:

Detyrën time do ta ushtroj me përgjegjësi dhe dinjitet.

Përkushtimi im do të jetë vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe shkallës së humbjes së aftësisë për punë të të sëmurit dhe invalidit.

Do të ruaj fshehtësinë për statusin e të sëmurit dhe invalidit. Do të ruaj konfidencialitetin e vendimmarrjes në Komision.

Në punën time me të sëmurët nuk do të ndikohem nga asnjë paragjykim kombëtar, racor, politik ose klasor.

Nuk do të lejoj, as në rrethana kërcënimi, që dija ime mjekësore të përdoret në kundërshtim me ligjet.

Këtë betim e bëj solemnisht dhe me vullnet të lirë, duke u mbështetur në nderin dhe ndërgjegjen time profesionale dhe njerëzore”.

Formular 1

ANEKS 3

Nr. _____ Regjistrit

Data e regjistrimit ____/____/____

Shënim: Kjo rubrikë plotësohet nga pritësi i dokumentave në Agjencinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, pas marrjes në dorëzim të kërkesës.

Kjo ankesë do të regjistrohet në qoftë se është dorëzuar brenda 30 ditëve nga data e vendimit të KMCAP-it, të nivelit të parë.

ANKIM

KUNDËR VENDIMIT TË KMCAP-it, TË NIVELIT TË PARË

Drejtuar KMCAP-it Epror në ISSH

Depozituar në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore _____

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore _____

Pjesa e parë

TË DHËNA MBI GJENDJEN CIVILE

Emri _____

Datëlindja ____/____/____

Atësia _____

Vendbanimi _____

Mbiemri _____

Shënim: Kjo rubrikë do të plotësohet duke mbajtur parasysh regjistrimet në gjendjen civile.

Pjesa e dytë

TË DHËNA MBI VJETËRSINË NË PUNË DHE PERIUDHAT E SIGURIMIT

Deklaroj se kam këtë vjetërsi në punë dhe / ose periudha sigurimi:

Shërbim ushtarak: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Ish-kooperativë bujqësore: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Ndërmarrje / institucione: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

I/E punësuar në subjektin _____, nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

I/E punësuar në qytet: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

I/E punësuar në fshat: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Periudha të tjera të vlefshme si periudha sigurimi, sipas legjislacionit në fuqi:

Nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Deklaroj se kam përfituar pagesa nga sigurimet shoqërore për:

Paaftësi të përkohëshme në punë: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Aksident në punë / sëmundje profesionale: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Papunësi: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Barrë lindje: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Të tjera: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Shënim: Rubrika Përfitime të tjera i referohet edhe përfitimeve nga skemat e tjera sociale.

Pjesa e tretë

Drejtohem për herë të parë në KMCAP me Fletë – Drejtim nga Spitali ☐ Komisioni Mjekësor ☐ për sëmundjen _____.

KMCAP-i i rrethit _____, me Vendim nr. _____, datë ____/____/____, më deklaroi:

- a. Të aftë për punë: ☐
- b. Të paaftë për punën e fundit, por i aftë për punë tjetër: ☐
- c. Të paaftë për punë, por pa më njohur të drejtën për kujdestar: ☐

Me këtë vendim nuk jam dakort dhe duhet ta ankimoj në KMCAP-in Epror (brenda 30 ditëve).

Bashkëlidhur me ankesën është fotokopja e vërtetimit të KMCAP-it të rrethit.

Kërkoj që i gjithë dokumentacioni im, së bashku me ankesën, të dërgohet pranë KMCAP-it Epror.

Shënim: Kjo ru brikë plotësohet nga të sëmurët që kanë paraqitur kërkesë për pension invaliditeti për herë të parë.

Përfitoj pension invaliditeti:

a. Të plotë:

☐

b. Të plotë me të drejtë për kujdestar:

☐

c. Të pjesshëm:

☐

Për sëmundjen: _____

Nr. dosjes së pensionit: _____

Periudha e përfitimit të pensionit: nga data ____/____/____ deri në datën ____/____/____.

Në rikontrollin e datës ____/____/____, KMCAP-i i rrethit, me Vendim nr. _____, më deklaroi:

a. Të aftë për punë:

☐

b. Të paaftë për punën e fundit, por i aftë për punë tjetër:

☐

c. Të paaftë për punë, por pa më njohur të drejtën për kujdestar:

☐

Me këtë vendim nuk jam dakort dhe duhet ta ankimoj në KMCAP-in Epror (brenda 30 ditëve).

Bashkëlidhur me ankesën është fotokopja e vërtetimit të KMCAP-it të rrethit.

Kërkoj që i gjithë dokumentacioni im, së bashku me ankesën, të dërgohet pranë KMCAP-it Epror.

Shënim: Kjo rubrikë plotësohet nga invalidët që nga rikontrolli nuk janë dakort me vendimin e KMCAP-it.

Shënim: Vendosni shenjë X brenda kutisë për deklaratimet që bëni.

Ankesa përpilohet në dy kopje:

1. Kopja e parë mbahet nga Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore dhe bëhet pjesë e dosjes me dokumentacionin që dërgohet në KMCAP-in Epror;
2. Kopja e dytë mbahet nga ankuesi.

Ankuesi

(_____
(Emër mbiemër)

(_____
(Nënshkrimi)

Inspektori i pritjes së dokumentave

(_____
(Emër mbiemër)

(_____
(Nënshkrimi)

Dorëzuar në datën ____/____/____

Pranuar në datën ____/____/____

VENDIM Nr. _____

Komisioni Epror i Caktimit të Aftësisë për Punë, i mbledhur më datë ____/____/____, pasi dëgjoi relacionin e përgatitur nga z./znj. _____, mjek / ekspertizës mjekësore pranë ISSH, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e z./znj. _____, që me Vendim nr. _____, datë ____/____/____, të KMCAP të rrethit _____, është deklaruar _____, sepse vuan nga sëmundja: _____

Mbasi e vizitoi të sëmurën / sëmurin, KMCAP- i Epror _____, konstatoi se vuan nga sëmundja: _____

Mbështetur në dokumentat, diagnozën, natyrën e punës, si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë _____ se _____ ka humbur aftësinë për punë në masë të _____, prej datës ____/____/____ deri më ____/____/____.

Koha e fillimit të invaliditetit: _____

Këshilla mjekësore për riaftësim: _____

Aftësia për punë: _____

Rikontroll në KMCAP-in Epror _____, në muajin _____

Invalidi _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Shënim: _____

Relatori (_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

(_____) (_____) (_____) (_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)